

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“AVIA GROUP” SHPK**

Sot, më datë 16/02/2021, ne shtetasit :

- ❖ **ISMAIL VASKA** , atësia Besnik , amësia Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Shyqyri Ishmi; Nr.86, Njësia Administrative Nr. 2;lindur më 07.01.1994, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i Leternjoftimit ID nr. 031666853 dhe nr. personal J40107061J.
  
- ❖ **ANTONIE ANGJUSHEV**, atësia Pano , amësia Marica, shtetas Maqedonas, lindur në Kumanovo dhe banues në Shkup, UL. France Preshern BR.135, lindur më 25.10.1963, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i pashaportes se huaj (maqedonase) Nr B0957099 .

Me vullnetin tone, përpilojme këte akt themelimi të shoqërisë tregtare “AVIA GROUP” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojnë Shoqërinë Tregtare "**AVIA GROUP** " SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **AVIA GROUP** SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "**AVIA GROUP**" SH.P.K dhe me emrin tregtar AVIA GROUP. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Shitje dhe instalime për Sisteme Audio, Video dhe Ndriçimi, tregtimin me shumice dhe pakice Import - eksport, tregtimin me shumice dhe pakice të paisjeve të instalimeve ..

Sherbime të konsulences asistences në fushën e instalimeve për sistemet audio, video, ndriçim, etj për sektorët publik dhe privat si dhe çdo veprimtari tjetër tregtare që të jetë e ligjshme dhe e dobishme për veprimtarinë e shoqërisë.

Home-Hi-Fi; Home Automation ; Smart Home.

Sherbime të depozitimit dhe logjistikes, nëpër objekte të veta apo të treta si dhe shpërndarjen e të gjithë produkteve të lidhura me sektorin instalimeve për sistemet Audio, Video dhe Ndriçimi për të aritur qëllimin e objektit të shoqërisë. Aktivitete që kanë lidhje me studime dhe kërkime të tregut në sektorin përkatës dhe në vecanti aktivitete formimi dhe informimi, komunikime, korrespondence, seminare, konferenca, stazhe dhe kongrese. Ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të kompanisë në sektorin e organizimit të brendshëm të punës, të automatizimit, të perzgjedhjes dhe trajnimit të personelit, të perpunimit të të dhënave, çdo gjë në lidhje me realizimin e aktiviteteve të mesipërme. Shoqëria mund të krijojë apo të marrë pjesë në shoqëri sipërmarrje të përbashkëta, partneritete dhe të gjitha format e bashkëpunimit, brenda qëllimit dhe objektivave të saj.

## **NENI 5**

### **Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Njësia Administrative Nr.2, Rruga Shyqyri Ishmi, Nr.86.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

## **NENI 6**

### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është Lekë 50,000 (pesëdhjetë mijë lekë) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 50,000 (pesëdhjetë mijë lekë)

Numri total i kuotave: 2.

Numri total i pjesëve 2, ku secili ortak zotëron nga një kuote.

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

## **NENI 7**

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare AVIA GROUP Sh.p.k zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

1.Ortaku themelues :	<b>Antonie Angjushev.</b>
Numri i kuotave :	1
Numri i pjesëve :	1
Pjesëmarrja në Shoqëri :	50 %

Page | 2

Lloji i kontributit:	ne para
Vlera e kontributit	25,000 ( njëzetë e pesëmije) leke;
<b>2.Ortaku themelues :</b>	<b>Ismail Vaska.</b>
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesemarrja ne Shoqeri :	50 %
Lloji i kontributit:	ne para
Vlera e kontributit	25,000 ( njëzetë e pesëmije) leke;

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas rregjistrimit ne QKB, atehere ortaket vendosin qe kjo shume do te paguhet prej tyre jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare. Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

## **NENI 8**

### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndrryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 9**

### **Administratorët**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jete :

**Z. Ismail Vaska, i datëlindjes 07-01-1994, shtetas shqiptar, lindur ne Tiranë dhe banues ne Tirane. Person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr .031666853 dhe Nr. Personal J40107061J.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## **NENI 10**

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

#### **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues, u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaket jane njohes te gjuhes shqipe.

### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERIA "AVIA GROUP" SHPK**

**ISMAIL VASKA**

Ismail Vaska

Vaska

**ANTONIE ANGIJUSHEV**

Antonie Angjushhev